

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6304  
E premte, 30 prill 2021  
çmimi 0.40 €

## Bideni mban fjalim në Kongresin amerikan: Amerika po lëviz përpara

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEDRI HAMZA | FAQE 4-5

# FILLIMI I PUNËS I QEVERISË, SHUMË I ZBEHTË

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka kritikuar qeverinë Kurti për punët e deritanishme. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se vonesat për paraqitjen e planit qeverisës, mospajtimet e vaksinës kundër Covidit dhe dështimi në luftimin e pandemisë janë vetëm disa nga të metat e kësaj qeverie. Hamza ka thënë se fillimi i punës i kësaj qeverie është shumë i zbehtë. Sipas tij, me punën e deritanishme qeveria Kurti po tregon se nuk është aspak premtuese



## RINISJA E DIALOGUT KOSOVË - SERBI, NË QERSHOR

FAQE 3

Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, pas takimit në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rinisë para fundit të qershorit



### OPINION

#### NGJASHMËRIA NË MES TË CERN-IT EVROPIAN DHE FERMILABIT AMERIKAN F. 10

Nga: Naim KRASNIQI, fizikan



### AKTUALE



#### NATO NIS STËRVITJET USHTARAKE NË SHQIPËRI F. 3

#### PËR 24 ORË EDHE NËNTË TË VDEKUR NGA COVIDI NË KOSOVË F. 7

### EKONOMI

#### KMDLNJ PËR PAGESËN E RRYMËS NË VERI: SHTETI PO ZBATON STANDARDE TË DYFISHTA NË BAZA ETNIKE F. 9

#### KËRKOHEM TË RISHIKOHEM QË DISA LIGJE QË KANË TË BËJNË ME FUNKSIONALIZIMIN E BIZNESEVE F. 9



### SPORT

#### SOT ZHVILLOHEN NDESHJET GJYSMËFINALET E TETA NË BASKETBOLL F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Bideni mban fjalim në Kongresin amerikan: Amerika po lëviz përpara

WASHINGTON, 29 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka paraqitur propozime gjithëpërfshirëse për punë, arsim dhe kujdes social teksa mbajti fjalimin e parë të madh përpara Kongresit amerikan. Bideni foli në prag të 100-ditëshit në detyrë dhe shfaqti shpresën se ekonomia amerikane, e goditur rëndë nga pandemia e koronavirusit, do të ringjallet. Ai u ndal tek administrimi i vaksinave kundër koronavirusit në ShBA, duke e përshkruar atë si "një nga arritjet më të mëdha logjistike në historinë e ShBA-së".

Biden, megjithatë, ka thënë se qeveria e tij duhet të bëjë më shumë për ta kthyer vendin në këmbët e veta dhe për të siguruar se ai do të udhëheqë botën në dekadat e ardhshme. Për këtë qëllim, ai ka pohuar se planifikon shpenzime masive prej 4 trilionë dollarësh. "Amerika po lëviz. Po lëviz përpara. Dhe ne nuk mund të ndalojmë tani. Ne jemi në garë me Kinën dhe vendet e tjera për ta fituar shekullin 21", ka thënë Biden.

Bideni ka theksuar se plani i tij për vende pune parasheh 2.3 trilionë dollarë, ndërsa plani

për familjet 1.8 trilion të tjerë. Ai ka thënë se rritja e shpenzimeve do të paguhet nga taksat më të larta për korporatat dhe të pasurit, por ky propozim është refuzuar më herët nga republikanët, e madje edhe nga disa demokratë të tij.

Presidenti amerikan u bëri thirrje republikanëve që ta mbështesin vizionin e tij, duke thënë se plani i tij për infrastrukturë do të krijonte miliona vende pune, ndërsa plani për familjet do t'i përgatiste të rinjtë për punë të teknologjisë në të ardhmen. "Pjesa tjetër e botës nuk po na pret. Të mos bësh asgjë nuk është opsion", është shprehur Biden.

Sipas disa analistëve, presidenti bëri përpjekje të lidhë politikën e tij të shpenzimeve dhe konkurrencën me Kinën, për ta fituar mbështetjen e republikanëve. Si republikanët, ashtu edhe demokratët, janë të shqetësuar për rritjen e fuqisë ekonomike dhe ushtarake të Kinës.

Plani i Bidenit për familjet ka në shënjestër familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Ai do të siguronte arsim universal parashkollor, dy vjet



kolegj falas, qasje në kujdes të përbalueshëm për fëmijët, pushime më të gjata familjare dhe ulje taksash.

Sondazhet tregojnë se më shumë se gjysma e amerikanëve e miratojnë punën që Bideni ka bërë deri më tani, por administrata e tij pritet të përballet me një luftë të gjatë në Kongres për t'i kaluar planet e shpenzimeve dhe taksave.

Lufta më e ashpër do të jetë në Senat, i cili është i ndarë 50-50 midis republikanëve dhe demokratëve.

Bideni foli edhe për nevojën e reformimit të policisë, pas vrasjes së George Floydit. Floyd, afrikano-amerikan, është vrarë nga një polic i bardhë në qytetin e Minesotës, vitin e kaluar. Rasti i tij ka shkaktuar disa muaj protesta kundër racizmit në ShBA. Presidenti përmendi disa herë Kinën si konkurrenten kryesore të Shteteve të Bashkuara për dominimin global në dekadat e ardhshme. Ai ka thënë se Shtetet e Bashkuara do "t'u bëjnë ballë" praktikave të padrejta tregtare

të Pekinit që dëmtojnë punëtorët amerikanë.

Biden, po ashtu, ka thënë se ShBA-ja do të mbajë një prani "të fortë" ushtarake në Indo-Paqësor për qëllime të mbrojtjes.

Biden ka theksuar se ia ka bërë të qartë presidentit rus, Vladimir Putin, se veprimet e Kremlinit, të tilla si ndërhyrja në zgjedhje dhe sulmet kibernetike, do të kenë pasoja, por shtoi se ShBA-ja dhe Rusia mund të bashkëpunojnë në çështje me interes të përbashkët.

## Bullgaria do ta dëbojë një diplomat rus



SOFJE, 29 PRILL - Ministria e Punëve të Jashtme e Bullgarisë ka njoftuar të enjten se do të dëbojë një diplomat rus. Moskë menjëherë u kundërpërgjigj se do të veprojë në një ndaj diplomatëve të Bullgarisë.

Tensionet diplomatike vijnë pasi të mërkurën prokurorët bullgarë thanë se po hetojnë përfshirjen e mundshme të gjashtë rusëve në katër shpërthime midis 2011 dhe 2020 në depot bullgare të armëve që po ruanin municione për eksport në

Ukrainë dhe Gjeorgji. Bullgaria kërkoi që Rusia të bashkëpunojë në hetimet e saj. Zëdhënësjë e Prokurorit të Përgjithshëm bullgar, Siika Mileva, tha se ekziston një "supozim i arsyeshëm" se këto incidente janë të lidhura me helmimin gati fatal të tregtarit bullgar të armëve Emilian Gebrev më 2015 dhe një shpërthim në një depo çeke municionesh më 2014. Çekia ka thënë se dyshohet që agjentët rusë janë përgjegjës për shpërthimin.

Praga ka dëbuar disa diplomatë rusë duke nxitur hakmarrjen e Moskës për dëbimin e diplomatëve çekë.

Në shenjë solidariteti, disa anëtarë të NATO-s dhe BE-së kanë dëbuar diplomatët rusë gjithashtu për pretendime spiunimi.

Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, tha të mërkurën se BE-ja duhet të përgatitet për përkeqësim të marrëdhënieve me Rusinë.

## Kina lanson modulin kryesor të stacionit të saj hapësinor

PEKING, 29 PRILL - Kina ka lansuar të enjten modulin kryesor të stacionit të saj të hapësirës, raporto i media shtetërore. Moduli pa pilot, Tianhe, i cili përmban pajisje dhe hapësirë për jetesë për tre astronautë, u nis me një raketë transportuese nga qendra hapësinore Uençang, në ishullin Hainan. Pekini planifikon të bëjë

edhe 11 nisje të tjera me module përpara se të përfundojë stacionin hapësinor Tiangong vitin e ardhshëm. Stacioni do të ketë një jetëgjatësi prej së paku 10 vjetësh.

I vetmi stacion hapësinor në orbitë aktualisht është Stacioni Ndërkombëtar i Hapësirës - një bashkëpunim i Rusisë, Shteteve të Bashkuara,

Kanadasë, Evropës dhe Japonisë. Kinës i është bllokuar pjesëmarrja në të. Stacioni Ndërkombëtar i Hapësirës pritet të pensionohet në vitin 2024. Kina ka shtuar programin e saj hapësinor në vitet e fundit me vizitat në Hënë, nisjen e një sonde pa pilot në Mars dhe tani ndërtimin e stacionit të saj hapësinor.



# Rinisja e dialogut Kosovë - Serbi, në qershor

Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, pas takimit në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rinisë para fundit të qershorit

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**BRUKSEL, 29 PRILL** - Rinisja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të ndodhë para fundit të qershorit ka thënë të enjten përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, pas takimit në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

Kurti ka konfirmuar se Kosova do të marrë pjesë në rifillimin

e dialogut në muajin qershor. Ai ka thënë se dialogu nuk do të neglizhohet nga ana e Kosovës mirëpo, siç ka thënë ai, ky proces duhet të zhvillohet mbi bazën e parimeve. "Javën tjetër në Prishtinë ne do ta miratojmë programin qeverisës dhe planin e punës, pastaj ai do të dërgohet në kuvend. Në anën tjetër, neve na duhen më shumë dokumente për dialogun e kaluar që të përgatitemi. Në maj do të

takohemi me opozitën për t'i pasur qëndrimet e saj. Së pari do ta kemi darkën e liderëve të Ballkanit Perëndimor në maj, pastaj edhe në qershor do ta fillojmë kapitullin e ri të dialogut", ka deklaruar Kurti.

Ndërkaq, shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, ka thënë se Kosova nuk ka alternativë tjetër përveç dialogut me Serbinë dhe se rruga e saj evropiane kalon përmes këtij dialogu. "Rruga evropiane e Kosovës kalon përmes dialogut Kosovë-Serbi, nuk ka rrugë tjetër dhe nuk ka alternativë. Arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Serbinë është thelbësore për të lëvizur në perspektivën evropiane. Në të kundërtën, rruga do të jetë e bllokuar", ka deklaruar Borrell pas takimit në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. "Nuk do të jetë e lehtë, por për përfitimin e njerëzve në Kosovë dhe Serbi dhe në rajon duhet që ky proces të

vazhdojë shumë shpejt", është shprehur Borrell.

Kurti ka qëndruar në Bruksel në një vizitë dyditore, ku ka zhvilluar takime me drejtuesit e institucioneve kryesore të BE-së.

Një ditë më parë ai u ka thënë gazetarëve në Bruksel se nuk do të merrte pjesë në takimin më 11 maj si pjesë e vazhimit të dialogut me Serbinë.

Takimi u njoftua fillimisht nga Borrell, gjatë vizitës të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel, këtë javë.

Kurti të enjten u takua në Bruksel edhe me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg.

Në takim u bisedua për situatën aktuale të sigurisë në Kosovë. Kryeministri Kurti ka shprehur mirënjohje për rolin historik të NATO-s në Kosovë dhe ka theksuar se prania e NATO-s është e një rëndësie të veçantë për forcimin e paqes dhe të stabilitetit në vend dhe

rajon. Ai ka konfirmuar qëllimin dhe aspiratën e hapur të Kosovës për integrim e anëtarësim në NATO, që do t'i kontribuonte sigurisë së rajonit dhe Evropës, ndërsa ka falënderuar sekretarin Stoltenberg për ndihmën dhe bashkëpunimin e KFOR-it me institucionet e Republikës së Kosovës në menaxhimin dhe reagimin ndaj pandemisë Covid-19.

Kurti në vizitën e tij të parë në Bruksel, që prej se është zgjedhur kryeministër i Kosovës, po ashtu do të marrë pjesë në një seancë të Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian.

Të mërkurën delegacioni i Kosovës, që përbëhet nga Kurti dhe dy zëvendësit e tij, Donika Gërvalla dhe Besnik Bislimi, kanë takuar komisionarë të BE-së për çështje ekonomike, energji, bujqësi, zhvillim rural dhe financa.



## NATO nis stërvitjet ushtarake në Shqipëri

**TIRANË, 29 PRILL** - NATO nisi të enjten stërvitjet ushtarake në Shqipëri, me pjesëmarrjen e mijëra forcave nga Shtetet e Bashkuara.

Koloneli amerikan Joseph Scrocca ka bërë me dije se stërvitjet në këtë shkallë janë të parat në Ballkanin Perëndimor që nga Lufta e Dytë Botërore. Ai ka thënë se Shqipëria është "një aleate e vendosur e NATO-s që nga viti 2009" dhe "një partnere e vlerësuar e sigurisë - si në rajon, ashtu edhe në nivel global".

Trupat amerikane janë vendosur në Shqipëri qysh më 26 prill. Ato do të mbajnë stërvitje në gjashtë baza tokësore, detare dhe ajrore në Shqipëri deri më 10 qershor. Shumica e vendeve të Ballkanit


Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, Kroacinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, janë vende anëtare të NATO-s.

"Ky mision historik demonstroi aftësinë tonë për të shërbyer si një partner strategjik i sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe në rajonet e Detit të Zi", ka deklaruar Scrocca.

Stërvitjet e koduara si "DEFENDER-Europe 21" janë ushtrime vjetore shumëkombëshe të cilat udhëhiqen nga ShBA-ja.

Natyrë e tyre është mbrojtëse dhe përqendrohet në parandalimin e agresionit.

Në kuadër të tyre, rreth 28 000 forca të ShBA-së dhe 26 vendeve të tjera do të kryejnë operacione gati të njëkohshme në më shumë se 30 zona



trajnimi, nisur nga Baltiku dhe Afrika deri në rajonet e Detit të

Zi dhe Ballkanit. Scrocca tha se stërvitjet si këto

janë "shembulli kryesor i aftësive tona kolektive".



FLET PËR "EPOKËN E RE", BEDRI HAMZA

## Fillimi i punës i qeverisë, shumë i zbehtë

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka kritikuar qeverinë Kurti për punët e deritanishme. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se vonesat për paraqitjen e planit qeverisës, mospunimi i vaksinës kundër Covidit dhe dështimi në luftimin e pandemisë janë vetëm disa nga të metat e kësaj qeverie. Hamza ka thënë se fillimi i punës së kësaj qeverie është shumë i zbehtë. Sipas tij, me punën e deritanishme qeveria Kurti po tregon se nuk është aspak premtuese

e Republikës së Kosovës. Ne nuk kemi kurrfarë oferte konkrete në këtë drejtim, por në këtë situatë ne jemi parti opozitare dhe kontributin tonë do ta japim në Kuvendin e Kosovës. Pra, aty do ta mbrojmë interesin e Kosovës", ka thënë Hamza.

**"Epoka e re":** Z. Hamza, ka kaluar një muaj qëkur qeveria Kurti ka marrë mandatin dhe ende nuk ka sjellë në Kuvend planin qeverisës. Si e keni parë këtë vonesë të qeverisë?

**Hamza:** Vonesa për sjelljen e planit qeverisës në Kuvend është dobësi e kësaj qeverie. Do të ishte mirë që me plan të vinte në qeveri sepse ka qëndruar gjatë në opozitë dhe është dashur ta ketë gati planin qeverisës ose, të paktën, në ditët e para të qeverisjes do të duhej ta paraqiste planin, ndoshta jo shumë të detajuar, por të paktën në vija të trasha. Kjo vonesë tregon një dobësi të qeverisë dhe një mungesë përkushtimi të saj.

**"Epoka e re":** Si do ta vlerësoni punën e deritashme të qeverisë?

**Hamza:** Për hir të korrektësisë, është periudhë e shkurtër për ta vlerësuar punën e qeverisë. Ndoshta qeveria ka nevojë për një kohë pak më të gjatë. Unë nuk jam prej atyre që bëj shumë temë një muaj të qeverisjes apo 100-ditëshin e qeverisjes, mirëpo indikacionet e para nuk janë shumë premtuese.

**"Epoka e re":** Z. Kurti ka ardhur në pushtet me premtimin se prioritet kryesor do ta ketë çështjen e pandemisë. A po e përmbush këtë premtim?

**Hamza:** Deri më tani në këtë drejtim qeveria ka probleme substanciale. Kemi mungesë të programit, mosadresim të pandemisë dhe rreziqet që po i sjell kjo pandemi. Ne po ballafaqohemi me humbje të shumë jetëve të njerëzve dhe me rrezikimin e shëndetit të njerëzve. Gjithashtu, është një

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 29 PRILL** - Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka bërë me dije se fillimi i punës së qeverisë Kurti është shumë i zbehtë. Ai ka vlerësuar se mungesa e planit qeverisës tregon se kjo qeveri nuk është premtuese.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka kritikuar qeverinë edhe për mosvendosje të drejtë të prioriteteve. "Fillimi i punës së kësaj qeverie është shumë i

zbehtë. Nuk është premtues aspak. Në bazë të asaj që kemi parë deri më tani, po vërehen shumë vonesa dhe lëshime në drejtime të ndryshme. Gjithashtu, ajo që është vërejtur gjatë kësaj kohe ka qenë mosvendosja e drejtë e prioriteteve qeverisëse", ka deklaruar Hamza.

Deputeti i PDK-së ka bërë me dije se kur një parti opozitare vjen në pushtet, planin qeverisës duhet ta ketë gati qysh në ditët e para. "Vonesa për sjelljen e planit qeverisës në Kuvend është dobësi e kësaj qeverie. Do të ishte mirë që ata me plan të vinin në qeveri, sepse kanë qëndruar gjatë në

opozitë dhe është dashur ta kenë gati planin e tyre qeverisës. Ose të paktën në ditët e para të qeverisjes do të duhej ta prezantonin planin e tyre, ndoshta jo shumë të detajuar, por të paktën në vija të trasha. Kjo vonesë tregon një dobësi të qeverisë dhe një mungesë përkushtimi të saj", është shprehur ai.

Në këtë intervistë Hamza ka folur edhe për qasjen që PDK-ja do ta ketë ndaj dialogut Kosovë-Serbi. Ai ka thënë se për këtë proces kjo parti kontributin e saj do ta japë në Kuvendin e Kosovës. "E thashë se PDK-ja do ta japë kontributin e saj në Kuvendin

# Ekspertët e Grupit për Ballkan angazhohen në procesin e dialogut

Ekspertët e Grupit për Ballkanin, Bernard Nikaj, Leon Malazogu, Robert Muharremi, Muhamet Mustafa e Veton Surroi, janë angazhuar ekspertë të jashtëm për procesin e dialogut të Kosovës me Serbinë. Ky angazhim i tyre është bërë i mundur me anë të një memorandum mirëkuptimi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Ambasadës së Norvegjisë. Grupit pritet t'i bashkohet edhe Blerim Shala

që janë angazhuar deri më tash janë Bernard Nikaj, Leon Malazogu, Robert Muharremi, Muhamet Mustafa e Veton Surroi, ndërsa pritet të bashkohet edhe Blerim Shala. "Ekspertët e angazhuar ofrojnë ekspertizë, mbështetje profesionale dhe përmbajtjesore për procesin e dialogut, dhe i vihen në dispozicion kryeministrit, kabinetit të tij dhe zëvendëskryeministrit për Integritet Evropian, Zhvillim dhe Dialog. Ekspertët e jashtëm nuk kanë rol përfaqësues apo udhëheqës dhe kontraktohen vetëm nga Grupi për Ballkan. Ekspertët e angazhuar deri më tani janë:

Bernard Nikaj, Leon Malazogu, Robert Muharremi, Muhamet Mustafa, Veton Surroi. Së shpejti grupit të ekspertëve pritet t'i bashkohet edhe Blerim Shala. Ekspertët të tjerë mund të ftohen dhe angazhohen varësisht prej nevojave të qeverisë dhe dinamikës së procesit të dialogut" është thënë në njoftim, duke shtuar se ky aktivitet përbën njërin nga komponentët programor të Grupit për Ballkan, të cilat implementohen me mbështetjen e Qeverisë së Norvegjisë në kuadër të kornizës "Zhvillimi i paqes & shtetndërtimit dhe avancimi i agjendës evropiane".

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Grupi për Ballkan ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Ambasadën e Norvegjisë, i cili përcakton modalitetet për angazhimin e

ekspertëve të jashtëm për procesin e dialogut të Kosovës me Serbinë dhe agjendave të tjera që ndërlidhen me dialogun. Sipas një njoftimi për media të Grupit për Ballkanin, ekspertët



kosto e madhe e njerëzve dhe familjarëve të tyre që po përballem me virusin. Pastaj në aspektin ekonomik nuk po shoh se kjo qeveri është në drejtimin e duhur dhe po ndjek masat e duhura. Ka një mospërputhje mes asaj çfarë ndërmerr dhe si ndikon ajo në ekonomi. E kuptoj se pandemia ka efektin e vet, por shohim se vendet e tjera, sidomos vendet e rajonit, e kanë trajtuar më ndryshe dhe më mirë pandeminë.

**"Epoka e re":** Kritikata kryesore ndaj kësaj qeverie kanë të bëjnë me mospërputhjen e vaksinës. A ka mundur të bëjë më tepër qeveria në këtë drejtim?

**Hamza:** Nëse të gjitha vendet e Evropës dhe të rajonit kanë bërë më shumë dhe kanë siguruar vaksinat, dikush më shumë e dikush më pak, sigurisht se kjo qeveri ka mundur të bëjë më tepër. Mjetet i ka në buxhet për ta bërë një gjë të tillë. Në bazë të këtyre fakteve po del se faktori njeri është problemi. Kur vendet e rajonit kanë mundur të bëjnë kontrata me kompani të ndryshme për sigurim të vaksinave, këtë gjë ka mundur ta bëjë edhe Kosova. Deri më tani ne kemi pranuar një kontingjent shumë simbolik të vaksinave dhe ai është donacion i COVAX-it.

**"Epoka e re":** Në bazë të asaj që keni parë deri më tani, cilat janë pritet tuaja për këtë qeveri?

**Hamza:** Fillimi i punës së kësaj qeverie është shumë i zbehtë. Nuk është premtues aspak. Në bazë të asaj që kemi parë deri më tani, po vërehen shumë vonesa dhe lëshime në drejtime të ndryshme. Gjithashtu, ajo që është vërejtur gjatë kësaj kohe ka qenë mosvendosja e drejtë e prioriteteve qeverisëse.

**"Epoka e re":** Si do të duhej të vendoseshin prioritetet, sipas jush?

**Hamza:** Prioritet kryesor do të duhet të ishte trajtimi i pandemisë, sigurimi i

vaksinave dhe rimëkëmbja ekonomike. Natyrisht se nuk do të duhej të mungonte edhe adresimi i prioriteteve të tjera. Gjithashtu, politika e jashtme do të duhej të merrej shumë seriozisht.

**"Epoka e re":** Tani jemi në prag të vazhdimi të dialogut me Serbinë. Çfarë pritni prej kësaj qeverie në këtë proces?

**Hamza:** Në fakt, dialogu veç po ndodh. Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, dhe emisari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, punë tjetër nuk kanë përveç dialogut Kosovë - Serbi. Pra, takimet e institucioneve të Kosovës janë duke ndodhur me

z. Lajçak dhe z. Borell. Ata sigurisht nuk bisedojnë për ambientin, por për dialogun në mes të dy vendeve.

**"Epoka e re":** BE-ja ka bërë me dije se shumë shpejt mund të ndodhë takimi i parë Kurti - Vuçiq. Sa besoni se është e përgatitur qeveria për këtë proces?

**Hamza:** Këta po thonë se kanë nevojë të përgatiten për dialogun, mirëpo këta është dashur të jenë të përgatitur për këtë proces. Pra, është dashur të jenë të përgatitur e jo kur të vijnë në qeveri me pa se çfarë duhet të bëjnë. Në qeveri vihet për të punuar dhe për të dhënë rezultate dhe jo për të mësuar se çfarë duhet për të bërë.

**"Epoka e re":** Cili do të jetë qëndrimi i PDK-së për procesin e dialogut?

**Hamza:** Ne do ta japim kontributin tonë në Kuvendin e Kosovës.

**"Epoka e re":** Kryeministri ka thënë se për këtë proces Kosovës i duhet një konsensus nacional. Nëse do të keni ofertë nga qeveria, mund të përfshihet PDK-ja në këtë proces?

**Hamza:** E thashë se PDK-ja do ta japë kontributin e saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne nuk kemi kurrfarë oferte konkrete në këtë drejtim, por në këtë situatë ne jemi parti opozitare dhe kontributin tonë do ta japim në Kuvendin e Kosovës. Pra, aty do ta mbrojmë interesin e Kosovës.

# Rëndësia e “non-papers” që po trazon Ballkanin



PRISHTINË, 29 PRILL - Në javët e fundit janë publikuar dy të ashtuquajtura “non-papers” mbi çështje të ndjeshme politike që kanë trazuar një pjesë të Ballkanit Perëndimor. Ajo që ndryshon me këto “non-papers” nga ato që zakonisht qarkullojnë nëpër korridoret e Brukselit, është se shumë pak, nëse ka, politikanë dhe diplomatë evropianë që vërtet duket se i posedojnë këto dokumente.

Kjo nënkupton se gjërat duket se po lëvizin në këtë rajon, veçanërisht ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe se dikush ose dëshiron t'i testojë ujërat me ide të ndryshme ose, ndoshta, është më djallëzor dhe dëshiron t'i shkatërrojë gjërat.

“Non-papers” janë pjesë e procesit të Brukselit. Qindra prej tyre zakonisht qarkullojnë në mesin e diplomatëve të cilët merren me çështje të ndryshme. E gjithë ideja e këtyre dokumenteve është që të nxiten diskutime brenda bllokut në mënyrë që të dilet me ide të reja në një mënyrë joformale. Prandaj, quhet “non-paper”. Ky dokument nuk është dokument zyrtar dhe nuk nënshkruhet e as miratohet përmes ndonjë vote të ndonjë eurodeputeti të zgjedhur.

Të gjitha këto dokumente normalisht kanë dy gjëra të përbashkëta: së pari, ato nuk janë nxitëse, shkruhen nga zyrtarë dhe burokratë për një temë shumë specifike dhe

shpesh jo për tema të rëndësishme. Së dyti, shteti që është autor i një “non-paper” zakonisht ka dëshirë që atij dokumenti t'i bashkohen edhe të tjerët, në mënyrë që si i tillë të ketë më shumë rëndësi, prandaj zakonisht autorët janë të hapur që ta ndajnë një dokument të tillë me të tjerët. Tekefundit, gjithkush do që të ketë publicitet për idetë e tyre të shkëlqyeshme. Dy “non-papers” të pretenduar, që dolën në media javët e fundit, nuk kanë këto karakteristika. “Non-paperi” i parë, që u cilësua si “non-paperi sloven”, që mediati boshnjake më herët gjatë këtij muaji thanë se kryeministri sloven Janez Jansa i dërgoi presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, është më interesante.

I shkruar pa asnjë konsideratë për korrektësinë diplomatike të Brukselit, paturpësisht propozon ricaktimin e kufijve në linja etnike në ish-Jugosllavi dhe në Shqipëri. Për këtë dokument ende po diskutohet në media për shkak se Jansa dështoi ta mohojë ekzistencën e tij edhe pse ai ka thënë se nuk është autor i dokumentit dhe ka mohuar se e ka dërguar atë. Por, po ashtu ky dokument vazhdon të jetë aktualisht edhe për shkak të paaftësisë së zyrës së Michelit për të konfirmuar ose mohuar se ai ka pranuar një dokument të tillë.

Dokumentit tjetër, që u publikua më herët gjatë kësaj jave nga një

media në Kosovë, është i shkruar më mirë. Në dokumentin, që pretendohet se është hartuar nga Gjermania dhe Franca, parasheh marrëveshjen përfundimtare të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Megjithatë, aty nuk ka shumë elemente të reja, përveç se thuhet se marrëveshja duhet të arrihet deri në shkurt të vitit 2022 dhe aty parashihet krijimi i një rajoni të posaçëm në komunat në veri të Kosovës që banohej me shumicë serbe. Gjermania dhe Franca menjëherë mohuan se e kanë shkruar këtë dokument. Por, në të njëjtën kohë, ata nuk e përjashtuan mundësinë për ekzistimin e një dokumenti të tillë, duke rritur kështu edhe më shumë dyshimet.

Ka disa ngjashmëri në mes të këtyre dy dokumenteve që, po ashtu, i bëjnë që të dallojnë nga “non-paperi” tradicional. Fillimisht, ato nuk kanë tituj, data dhe askush në Bruksel nuk duket se i disponon të njëjtat – duke bërë që diplomatët, me shaka, t'u referohen këtyre dokumenteve si “non-papers që nuk ekzistojnë” ose “non-papers fantome”. Është e çuditshme që për “non-paper” nga Sllovenia u raportua se i është dërguar vetëm Charles Michelit dhe askujt tjetër (dhe po aq e çuditshme që zyra e tij as nuk e mohon e as pohon këtë gjë) dhe, po ashtu, është e çuditshme që “non-paperi” gjermano-francez

duket se buron nga Prishtina dhe nuk është dërguar diku tjetër.

Prej këtyre dy dokumenteve, ai që pretendohet se është shkruar nga Gjermania dhe Franca duket më shumë si një balon provues, edhe pse mund të mos e dimë kurrë se kush e lëshoi atë. Megjithatë, ka disa pikëpyetje. Pse të tregoni se çfarë përfundimi dëshironi të shihni? Ju mund të tregoni për hapat që do të ndërmerrni për ta arritur qëllimin, por pse t'i zbuloni të gjitha letrat e juaja? Gjithashtu, Franca dhe Gjermania shumë rrallë kanë të njëjtin qëndrim kur bëhet fjalë për Ballkanin Perëndimor, ku Berlioni është mjaft aktiv që ta afrojnë këtë rajon në BE, ndërkaq Franca në këtë drejtim, hapur është shprehur skeptike, duke e parë zgjerimin e bllokut si një pengesë për qëllim e saj kryesor që është forcimi i mëtejshëm i bllokut, duke marrë më shumë borxh të përbashkët ose duke rritur bashkëpunimin evropian sa i përket mbrojtjes. Sa i përket dokumentit sloven, ka spekulime se ka rrjedhë dhe është publikuar në media për të minuar qeverinë në Lubjanë, para se Sllovenia më vonë gjatë këtij viti, ta nisë kryesimin e presidencës së BE-së, por edhe mundësisë që pas gjithë kësaj qëndron Hungaria. Diplomatët evropianë më kanë thënë se ata dyshojnë se Rusia mund të jetë pjesë e gjithë kësaj, me qëllim që të nxisë mëdyshje dhe

konfuzion. Ky dokument duket se e ka arritur këtë qëllim, duke pasur parasysh që gazetarët po vazhdojnë të bëjnë pyetje për dokumentin dhe politikanët po detyrohen që vazhdimisht ta përsërisin mbështetjen e tyre për integritetin territorial të shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, këto dokumente – pavarësisht se a janë të vërtetë apo jo – lënë të kuptohet se gjërat kanë filluar që të lëvizin sërish në rajon. Me Albin Kurtin dhe Aleksandar Vuçiqin, Kosova dhe Serbia tani kanë dy liderë që kanë mbështetje dhe mandat që të arrijnë një marrëveshje, nëse duan ta bëjnë një gjë të tillë. Gjermania mund të përballet me zgjedhje të paqarta në vjeshtë, por vazhdon të jetë e përkushtuar për bisedimet, pavarësisht se cili do të jetë rezultati i zgjedhjeve. Por, duhet vëzhguar me vëmendje presidentin francez Emmanuel Macron që pritet të përballet në zgjedhjet e vitit të ardhshëm me nacionalisten Marine Le Pen.

Për shkak të zgjedhjeve lokale në Francë disa vite më parë ai kishte pezulluar rrugëtimin e Maqedonisë së Veriut drejt BE-së. Por, tani situata është më serioze – që do të thotë se dritarja për të arritur marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të jetë e hapur tash, por jo për një kohë shumë të gjatë.

(Përgatiti: Mimoza Sadiku /rel)

## Për 24 orë edhe nëntë të vdekur nga Covidi në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 PRILL - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR, si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT, janë testuar gjithsej 3 262 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 269 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar nëntë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë dy raste (85, 71 vjeç), Prizren dy raste (81, 60 vjeç), Ferizaj një rast (65

vjeç), Gjakovë një rast (58 vjeç), Gjilan një rast (67 vjeç), Lipjan një rast (85 vjeç), Mitrovicë një rast (75 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 104 986 raste nga 530 954 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2 162 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 449 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 93 528 raste, kurse numri i rasteve aktive është 9 296.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 49 raste, Ferizaj 30 raste, Mitrovicë 23 raste, Gjilan 17 raste, Vushtrri 17 raste, Gjakovë 13 raste, Prizren 13 raste, Podujevë 12 raste, Klinë 11 raste, Fushë-Kosovë 10 raste, Pejë 10 raste, Graçanicë 7 raste, Lipjan 7 raste, Obiliq 7 raste, Skenderaj 6 raste, Malishevë 5 raste, Drenas 4 raste, Kaçanik 4 raste, Rahovec 4 raste, Suharekë 4



raste, Dragash 3 raste, Zubin-Potok 3 raste, Deçan 2 raste, Istog 2 raste, Shtime 2 raste, komunitat Kamenicë dhe Viti 2 raste dhe me nga një rast Leposaviq.

## Kosova edhe këtë vit me kadetë të rinj në akademitë ushtarake të ShBA-së



PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Në kuadër të bashkëpunimit, partneritetit dhe mbështetjes së vazhdueshme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe pas një procesi të konkurrencës

shumë të fortë nga qindra konkurrentë nga shumë shtete të ndryshme të botës, kandidatët Enderon Vuthaj dhe Arlind Shefiku janë dy studentë kadetë të radhës të përzgjedhur të Kosovës për të studiuar në Akademinë e

Forcave Ajrore dhe Akademinë Ushtarake të ShBA-së West Point. "Studentë kadetët e rinj, Enderoni dhe Arlindi, me suksesin e tyre kanë nderuar dhe bërë krenare Kosovën dhe urojmë që pas katër vjetëve të

studimeve, me dijen dhe shkathtësitë e tyre, të kthehen për t'i shërbyer vendit tonë. ShBA-ja, si partnerja jonë kryesore strategjike, vazhdon përkrahjen gjithëpërfshirëse për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së

Kosovës që nga fusha e arsimimit dhe trajnimit, donacionet në pajisje, këshillime profesionale e deri te stërvitjet dhe operacionet e përbashkëta", bëhet me dije në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

## Jasharaj i SBASHK-ut, kërkesa të reja për punëtorët e arsimit

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) ka kërkuar nga drejtoritë komunale të arsimit që të pajisin me vendime individuale secilin mësimdhënës që angazhohet në mësimin plotësues. Ata, po ashtu, kanë kërkuar edhe pagesë të orëve plotësuese

nëse të njëjtat e kalojnë normën javore prej 20 orësh mësim.

SBASHK-u, drejtues i së cilës është Rrahman Jasharaj, ka njoftuar se nëse nuk u plotësohet kërkesa, do t'u bëjë apel mësimdhënësve që të mos e fillojnë mësimin plotësues. "SBASHK-u iu drejtohet drejtorive arsimore

që përmes drejtorëve të shkollave të pajisin me vendime individuale secilin mësimdhënës që e angazhojnë në mësimin plotësues duke precizuar sa orë do t'i mbajnë, në cilën kohë e në cilin vend. DKA-të të mos harrojnë se norma javore është 20 orë mësim dhe se në Kontratën

Kolektive të Arsimit saktësohet se çdo orë e mbajtur mbi këtë normë duhet të paguhet si orë e rregullt. Në të kundërtën SBASHK-u i drejtohet me apel anëtarësisë, pra punëtorëve në arsimin parauniversitar, që të mos fillojnë me mësimin plotësues", thuhet në reagimin e SBASHK-ut.



## Prizreni, komuna e parë që ka përfituar nga programi “Subvencione për eficiencë të energjisë”

PRIZREN, 29 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Philip Kosnett, drejtoreshën e Korporatës së Sfidave të Mileniumit për Kosovë, Sarah Olmstead dhe drejtorin ekzekutiv të Fondacionit të Mileniumit të Kosovës, Petrit Selimi, ka bërë inaugurimin e punimeve për projektin “Subvencione për eficiencë të energjisë”.

Duke theksuar se Prizreni është komuna e parë që ka përfituar nga ky program, i

implementuar nga Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK) dhe mbështetur nga Korporata e Sfidave të Mileniumit, kryetari Haskuka ka thënë se ky program përqendrohet në uljen e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e banimit, përmes subvencioneve dhe stimujve të tjerë, për t'i inkurajuar familjet të investojnë në masa të eficiencës së energjisë. “Ky projekt është më se i qëlluar ngaqë duke udhëtuar në Kosovë vërejmë se kemi shumë shtëpi me blloqe të kuqe, të pafasaduara dhe të palyera.

Arsyet janë të shumta, por ne duhet të punojmë intensivisht që ta ndryshojmë këtë gjendje, ngaqë në këtë mënyrë familjet dhe fëmijët tanë do të kenë ambiente më të ngrohta gjatë dimrit dhe më fllad gjatë verës. Kështu, çmimet e faturave të rrymës do të ulen dhe këto pastaj do të mund të investohen në arsimimin e fëmijëve tanë. Përveç kësaj, me eficiencë të energjisë ne e mbrojmë edhe ajrin, natyrën dhe të ardhmen e tokës. Ne kemi vetëm një planet, prandaj nuk kemi opsion tjetër pos mbrojtjes së tij”, është shprehur Haskuka.



## Brenda katër muajve 228 lehona në Malishevë janë përkrahur me nga 100 euro



MALISHEVË, 29 PRILL (ER) - Në kuadër të zbatimit të vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, për përkrahje për çdo fëmijë që lind, në katër muajt e parë të këtij viti janë përkrahur me mjete 228 lehona, apo si shumë totale, 22 800 euro. Kështu ka bërë me

dije drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku.

Kuvendi i Komunës së Malishevës ka marrë vendim që të përkrahen nënat për çdo fëmijë që lindin me shumën prej 100 eurosh dhe ky vendim është duke u zbatuar prej

shtatorit të vitit 2018. Sipas drejtorit Mazreku, gjatë këtij viti janë paguar mjetet për 228 nëna lehona, të cilat kanë aplikuar për këtë përkrahje, ndërsa edhe brenda muajit maj, varësisht nga aplikimet, pritet të përkrahen edhe 150 nëna të cilat kanë lindur fëmijë.

## Lirohen nga taksa bizneset në Drenas

DRENAS, 29 PRILL (ER) - Me propozimin e kryetarit të Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, me vota unanime është votuar propozimvendimi për lirim nga taksa e operimit për të gjitha bizneset në Drenas si dhe janë liruar nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike (tarracave) për lokalet e gastronomisë për vitin 2021.

Po në këtë mbledhje të kuvendit komunal janë miratuar edhe disa pika, si procesverbali i mbledhjes së rregullt të kuvendit komunal të datës 26.03.2021, raporti financiar i zhvillimit të buxhetit janar-mars 2021, raporti i ndihmave dhe subvencioneve për vitin 2020 dhe propozimvendimi për bartjen e të hyrave vetjake nga viti 2020 në vitin 2021.



## Haziri pret përfaqësuesit e Education Code për fuqizimin e komunitetit të shurdhër

Gjilan, 29 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur të enjten në takim drejtoreshën e organizatës “Education Code”, Mimoza Stanovci, për fuqizimin e bashkëpunimit, i cili pritet të ndodhë në të ardhmen për fuqizimin e komunitetit të Shurdhër. Haziri ka theksuar bashkëpunimin e mirë me Shoqatën e të Shurdhërve në Gjilan, përkatësisht Orhan Bejta dhe Shpresa Orana, ku janë

realizuar projekte të rëndësishme për këtë komunitet, derisa ka konfirmuar se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe me organizatën “Education Code”. Drejtoresha e “Education Code”, Mimoza Stanovci, e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe ofrimin e bashkëpunimit në të ardhmen. Ajo ka thënë se ideja është që të realizohen projekte të trajnimit për mësimin e gjuhës së shenjave dhe të gjuhës shqipe.



# KMDLNj për pagesën e rrymës në veri: Shteti po zbaton standarde të dyfishta në baza etnike

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 PRILL - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që të gjejnë një zgjidhje të shpejtë për konsumatorët e papërgjegjshëm që nuk i paguajnë faturat për rrymën e shpenzuar dhe shërbimet e tjera komunale, në të kundërtën as konsumatorët e tjerë nuk do të duhej t'i paguajnë faturat.

KMDLNj thekson se nëse shteti ua paguan rrymën dhe shpenzimet e tjera komunale serbëve në veri të Kosovës, pa e përfillur fare gjendjen e tyre ekonomike, atëherë po ky shtet duhet t'i lirojë nga pagesa kategoritë e qytetarëve në gjendje të rëndë ekonomike apo të mbulojë një pjesë të këtyre shpenzimeve. "Që nga përfundimi i luftës serbët në veri të Kosovës, por edhe në

lokacionet e tjera ku jetojnë, nuk kanë paguar shpenzimet për energjinë e shpenzuar sigur edhe shërbimet e tjera komunale si faturat për ujë, mbeturina dhe të tjera. Madje faturat për këto shërbime u janë fryrë konsumatorëve shqiptarë dhe joserbë, duke i detyruar që të paguajnë, pa dijeninë dhe pëlqimin e tyre, faturat e serbëve dhe humbjet e KOSTT-it i cili edhe tani ka kërkuar që Qeveria e Kosovës të ndajë 11 milionë euro për energjinë e shpenzuar dhe të papaguar të serbëve në veri të Kosovës. Realisht, qeveria aktuale Kurti 2 nuk e ka shkaktuar këtë situatë, por se e ka trashëguar nga qeveritë e mëparshme, andaj edhe kritikata nuk e kanë efektin e duhur", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj ka bërë me dije se disa herë ka reaguar kundër trajtimit diskriminues që po e bën Qeveria e Kosovës ndaj qytetarëve të cilët i



diskriminon duke përdorur standarde të dyfishta. "Konsumatorët e rregullt i ndëshkon me çmime të larta, kurse operatori i shqyç nga rrjeti nëse vonohen edhe një ditë të vetme në shlyerjen e detyrimeve për energjinë e shpenzuar kurse, një kategorie

tjetër, përkatësisht serbët, ndonëse shpenzojnë rrymë sa të duan, jo që nuk i shqyç nga rrjeti i furnizimit, por ua paguan të gjitha faturat. Institucionet e Kosovës përkatësisht Qeveria e Kosovës duhet ta ndërpresë këtë praktikë të mbrapshtë të

zbatimit të standardeve të dyfishta për qytetarë të të njëjtit vend dhe nuk do të duhej t'i trajtojë qytetarët sipas përkatësisë etnike apo oportunitetit politik", thuhet në reagimin e KMDLNj-së. Kundër këtij vendimi të qeverisë kanë reaguar edhe partitë opozitare.

## Kërkohet që të rishikohen disa ligje që kanë të bëjnë me funksionalizimin e bizneseve

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Në vazhdim të takimeve të Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, kryetari Ferat Shala, së bashku me nënkryetarin e këtij komisioni, Pal Lekaj, kanë pritur të enjten në takim Skender Krasniqin nga Oda e Afarizmit e Kosovës dhe Hysen Sogojevën nga Oda e Hotelarisë dhe Turizmit e Kosovës.

Në mënyrë që nga ky komision t'u jepet hapësirë dhe mbështetje të nevojshme të të dy odave, kryetari Shala ka kërkuar nga përfaqësuesit e tyre që t'i shprehin nevojat dhe kërkesat kundrejt komisionit.

Përfaqësuesi i Odës së Afarizmit, Skender Krasniqi, ka kërkuar nga anëtarët e komisionit që disa nga ligjet të cilat kanë të bëjnë me funksionalizimin e bizneseve të rishikohen edhe një herë, në



veçanti Ligji për Investime Strategjike dhe ai për Sponsorim të

Mediaeve. "Këto ligje u mundësojnë bizneseve vendore

dhe të huaja të investojnë në Kosovë, e në këtë mënyrë rrisin

edhe mirëqenien tonë. Por, ne vlerësojmë se është shumë e vështirë kjo, nëse nuk vihen në diskutim për plotësim-ndryshim këto ligje", ka theksuar Krasniqi.

Kurse, nga ana e Odës së Hotelarisë dhe Turizmit të Kosovës, Hysen Sogojeva, u tha se nga Ligji për Rimëkëmbje përparësi duhet t'u jepet bizneseve që kanë humbur më së shumti. Sogojeva ka kërkuar që Ligji i Turizmit, që tashmë është kthyer në qeveri, ta parashohë edhe themelimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, e cila njihet si shtylla kryesore e turizmit. Kryetari dhe nënkryetari i komisionit shprehën gatishmërinë e tyre që takime të kësaj natyre të vazhdojnë edhe në të ardhmen në mënyrë që puna e përbashkët të jetë më proaktive.

## Klubi i Prodhuesve e njofton ministrin Murati për gjendjen e këtij sektori gjatë pandemisë

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Klubi i Prodhuesve i Kosovës gjatë takimit me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, kanë diskutuar për pozitën financiare të vendit, sidomos për gjendjen e prodhuesve gjatë

pandemisë Covid-19. Po ashtu gjatë takimit Klubi ka parashtruar disa kërkesa konkrete sa i përket sektorit të prodhimit dhe është kërkuar mbështetje e qeverisë për fuqizimin e këtij sektori, si një ndër bartësit kryesor të zhvillimit ekonomik të vendit.

Gjithashtu, gjatë takimit u përmendën edhe masat e domosdoshme për formalizimin e ekonomisë dhe zbatimin e ligjit, të cilat do të ndikonin drejtpërdrejt në tërheqjen e investimeve, bilancin tregtar dhe krijimin e vendeve të reja të punës.



CERN dhe FERMILAB kërkojnë forcën e pestë fundamentale të fizikës, që tashmë është zbuluar nga fizikani Naim Krasniqi (5)

# Ngjashmëria në mes të CERN-it evropian dhe FERMILABIT amerikan



Nga: Naim KRASNIQI, fizikan

CERN-i është një qendër evropiane për hulumtime shkencore bërthamore, kurse FERMILAB është një laborator amerikan i specializuar në fizikën e grimcave me energji të lartë. Analiza tregon qartë se nuk ka dallime midis energjisë bërthamore të qendra evropiane CERN dhe grimcave me energji të lartë të qendra amerikane FERMILAB, çfarë do të thotë se ekziston një ngjashmëri në orientimet e hulumtimeve shkencore të dy qendrave hulumtuese.

Nga ana e tjetër të dy laboratorët kanë përsheptues të grimcave. Qëllimi i dy qendrave krahas studimeve të tjera shkon në të njëjtin drejtim që të gjejnë në mënyrë eksperimentale si dhe përmes akceleratorëve të gjejnë grimcën nga e cila formohet energjia e zezë e cila formon forcën e pestë fundamentale të fizikës apo edhe ndonjë grimcë që ka shkaktuar fenomenin e Bing Bangut, apo ndryshe eksplozimit të madh.

Sa për Bing Bangun ajo është sqaruar edhe në botimet në "Epoka e re" 2016, 2019 dhe 2020 madje theksohet qartë se asnjëherë nuk ka ekzistuar një Bing Bang nga i cili është formuar universi, por mungesa e mosdashjes së njohjes së fushës antimagnetike në makrobotë dhe fushës antielektrostatike në mikrobotë e mbanë ende në jetë një fenomen inegzistent ndryshe një fenomen që nuk ka ekzistuar asnjëherë, por si do që të jetë ne do ta sqarojmë energjinë e zezë dhe ekspansionin e universit.

## Energjia e zezë dhe ekspansioni i universit

Në kosmologjinë aktuale:

1) Energjia e zezë është një formë hipotetike e energjisë e shpërndarë në mënyrë uniforme në mbarë universin, e cila energji sillet si një forcë negative që i kundërvihet forcës tërheqëse në mes trupave qiellorë, kurse 2) Ekspansioni i universit është një fenomen që ka të bëjë me fenomenin që ndodh në univers, përmes largimit të galaksive gjithnjë e më shumë nga njëra-tjetra.

### 1) Energjia e zezë

Sot për sot, për komunitetin shkencor thajse një ndër sfidat kryesore është për ta kuptuar mënyrën se si funksionon universi, prandaj është jetike të dihet se përse ekziston një stabilitet ndërplanetar apo ndërgalaktik i cili mendohet se është mbi 13 miliardë vit më parë është krijuar dhe vazhdon të funksionojë me të njëjtin stabilitet.

Një stabilitet të tillë për komunitetin shkencor që e mbanë këtë ekuilibër është energjia e zezë, për të cilën energji nuk dihet asgjë edhe përkundër përpjekjeve të pa ndërprera të komunitetit shkencor. Nëse nisemi nga natyra kjo na ndihmon më së shumti t'i zgjedhim problemet, sepse ne nëse nuk e shohim makrobotën si mund ta shohim mikrobotën, për këtë arsye le të

nisemi nga një shembull i thjeshtë nga planeti i ynë në të cilin jetojmë. Mendohet se toka në të cilën jetojmë është krijuar para 4,5 miliardë viteve, por edhe Hëna ka afërsisht të njëjtën vjetërsi. Toka rrotullohet rreth boshtit të vetë, kurse rreth saj në një orbitë të caktuar rrotullohet Hëna, por që të dy trupat qiellorë sikur toka ashtu edhe Hëna kanë formë sferike.

Kjo na tregon qartë se gjatë 4,5 miliardë viteve kanë arritur këta trupa qiellorë që ta ruajnë këtë formë sferike të padeformuar, edhe pse pandërprerë është rrotulluar Hëna rreth toke. Tani le të shkojmë pak përtej Hënës që rrotullohet rreth tokës, dhe themi se sikur Hëna që rrotullohet rreth toke gjithashtu edhe toka rrotullohet rreth diellit në një orbitë të caktuar. Prandaj po kuptohet se nëpër orbitat nëpër të cilën kanë kaluar Hëna rreth tokës, si dhe toka rreth diellit nuk kishte trupa qiellorë për rreth 4,5 miliardë vite që do ta rrezikonin tokën apo Hënën nga goditjet, përkatësisht nga deformimet e formave të tyre sferike.

Siç po shihet edhe pse trupat qiellorë rrotullohen rreth njëri-tjetrit, përkatësisht Hëna rrotullohet rreth toke, si dhe trupat e tjerë qiellorë duke e përfshi edhe tokën rrotullohen rreth diellit, natyra i ka krijuar këta trupa dhe natyra i ka formuar orbitat e tyre kurse këta trupa rrotullohen rreth njëri-tjetrit në një ekuilibër precizë për gjatë 4,5 miliardë viteve, dhe i ruajnë format e tyre sferike.

Tani shtrohet pyetja, si e sqarojmë

fizikanët e njohur këtë stabilitet precizë që vazhdon thuaja e 4,5 miliardë vite, e që trupat qiellorë rrotullohen rreth njëri-tjetrit në një stabilitet dhe të pa deformuar.

## Ligjet e fizikës tradicionale të Isaac Newtonit dhe Albert Einsteinit mbi stabilitetin e rrotullimit të trupave qiellorë

Le të nisemi nga dy trupat tonë të sistemit tonë diellorë, përkatësisht tokës në të cilën jetojmë dhe Hënës e cila rrotullohet rreth saj në një orbitë kur Hëna është në distancën më afër tokës rreth 356 511 km. Për një distancë të caktuar ashtu sikur u cekë më lartë, në fizikën tradicionale të Isaac Newton thuhet se forca tërheqëse në mes trupave qiellorë është proporcionale me masat e tyre, kurse në relativitetin gjeneral të Einsteinit thuhet se forca tërheqëse në mes trupave qiellorë shkaktohet nga deformimi i kohë-hapësirës. Duke mos hyrë në detaje sepse me kohë do sqarohen se të dy teoritë nuk janë funksionale, le të ndalemi te e përbashkëta e tyre sikur te Isaac Newton ashtu edhe te Albert Einstein kemi të njëjtin version, në mes trupave qiellorë vepron një forcë tërheqëse. Prandaj këtë askush nuk mund e konteston sepse sikur Isaac Newton ashtu edhe Albert Einstein e pranojnë forcën tërheqëse në mes trupave qiellorë

por në mënyra të ndryshme. Shtrohet pyetja si mund të veprojmë një forcë tërheqëse qoftë e bazuar në ligjin e Isaac Newtonit apo Albert Einsteinit pa ndërprerë për 4,5 miliard vite në mes tokës dhe Hënës, si dhe në mes diellit dhe planetëve të tjerë që rrotullohen rreth tij, si dhe ende këta trupa qiellorë mbesin në distanca dhe në një ekuilibër precizë i cili vazhdon edhe tani. I njëjti kriter vlen për të gjithë trupat qiellorë duke përfshi edhe galaksitë.

## Analizë shkencore

Te forca tërheqëse e Isaac Newton mungon faktori kohë, çka jep për të kuptuar se në një kohë të pambaruar trupat qiellorë tërhiqen në mes veti. Çka do të thotë ligji i gravitacionit tregon se trupat qiellorë vetëm tërhiqen, e tërhiqen e tërhiqen deri të takohen në mes veti, sepse nuk ka lënë asnjë hapësirë për veprimin e forcës shtytëse në mes trupave qiellorë.

Kurse Albert Einstein thekson se forca tërheqëse shkaktohet nga deformimi i kohë-hapësirës. Kjo e ka një kuptim më të thjeshtë që hapësira lakohet për shkak të masës së trupave qiellorë, që do të thotë se kur hapësira lakohet trupat qiellorë tërhiqen e tërhiqen deri të takohen në mes veti nga fakti se hapësira po lakohet. Apo ndryshe për ta kuptuar ma thjeshtë sa më i rëndë të jetë trupi qiellor aq më shumë hapësira lakohet hapësira dhe aq më shumë trupat qiellorë tërhiqen.

(Vijon)



Hysen Beqa lindi në Mollë të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit "Misiri i vogël", i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtit autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autori përsiat për veten, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjejmë shenja të autorit, por edhe të narratorit. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë pikëpamje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijojnë shoqëria.

Në këtë libër autori trajton fatin e shkrimtarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhjeve personale, del sheshit fati i shkrimtarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimtari ishte prijës popullor, sot ai është shtresë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narratorit homodiegetik, shkrimtarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narratorit Beqa mëton të tregojë se shkrimtaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikaneve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

*Albin Mehmeti*

5.99€



SHKRIMTARI

HYSEN BEQA

HYSEN BEQA



Kaltrina Pacolli  
Prishtinë

Zërin ngrite deri te Zoti.

Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.

Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.

Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.

Bërtit! Fol! Thuaje!


Unë jam gruaja më e fortë në botë!



6.99€



# UNË, KUFOMA E ARDHSHME



Kaltrina Pacolli

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## SOT ZHVILLOHEN NDESHJET GJYSMËFINALET E TRETA NË BASKETBOLL

PRISHTINË, 29 PRILL - Sot (e premte) do të zhvillohen ndeshjet e treta gjysmëfinale të "play-off"-it në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshjet tashmë zhvendosen në Pejë dhe Therandë, ku do të zhvillohen edhe sfidat e katërta gjysmëfinale, derisa skuadra që shënon tri fitore kualifikohet në finalen e madhe. Përballje shumë interesante pritet ndërmjet Pejës dhe Ponte Prizrenit ashtu siç ishin edhe

takimet e fundit. Ndeshjen e parë e fitoi Peja me shifrat 92:100, ndërsa takimin e fundit e fituan prizrenasit 112:111 pas vazhdimëve me një trepikësh nga Divine Myles në sekondat e fundit. Takimet mes tyre ishin shumë interesante, duke dhuruar lojë të bukur dhe atraktive, e kështu pritet të premtën mbrëma. 1:1 është seria edhe ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Rahovecit, duke e bërë shumë të paqartë se kush do të kualifikohet në finale. Dy

sfidat e para u zhvilluan në Rahovec, kurse sfidat e dyta do të zhvillohen në Therandë. Takimin e parë e fituan Vreshtarët 69:66, kurse të dytin therandasit 62:70. Në vitet e fundit përballjet në mes të këtyre dy skuadrave kanë qenë shumë interesante dhe kështu pritet të premtën dhe të dielën.

### TË PREMTËN TAKOHEN:

17:00 Peja - Ponte Prizreni (1:1)  
20:15 Golden Eagle Ylli - Rahoveci (1:1)



## Berisha: Besojmë në mrekullinë e kualifikimit në Kupën e Botës



Tiranë, 29 prill - Nga frika prej Covid-19 tek ëndrra e ngjitjes në Serinë A, por me një dyshim për të ardhmen. Megjithatë, Etrit Berisha ka ide të qarta për finalen e sezonit: "Ne duam të fitojmë sa më shumë pikë të jetë e mundur për ta kapur kreun e renditjes dhe luajtur 'play-off' sa më mirë. Kemi atë që duhet për t'u kthyer në "Seria A".

**Çfarë i mungonte Spal-it këtë vit?**  
**Berisha:** Ne kemi pasur shumë dëmtime dhe nuk kemi qenë në gjendje të mbajmë të njëjtin standard të performancës si në shtëpi, edhe jashtë. Gjithashtu kemi humbur besimin kur, pavarësisht lojës së mirë, disa rezultate nuk ishin të duhurat. Situata nuk ishte e lehtë për t'u menaxhuar. Gjithsesi, kemi ende

kohë për të rikuperuar.

**Në mes u ndryshua edhe trajneri...**

**Berisha:** Me Marinon kemi bërë mjaft mirë, gjithashtu duke marrë parasysh që po vinim nga një rënie dhe kjo ishte një goditje e rëndë për të gjithë. Pastaj patëm një rënie dhe duke pasur parasysh që ekipi nuk reagoi, ndryshimi në

drejtim ishte i nevojshëm. Rastelli u përpoq, mbi të gjitha, të punonte për besimin e grupit dhe reagimi ynë u pa.

**Ju jeni "numri një" në emër dhe në fakte: a jeni i lumtur për këtë?**

**Berisha:** Të jesh numri një nuk është e lehtë. Unë punoj shumë për të bërë ndryshimin në çdo ndeshje. Me kënaqësi e pranova sfidën e Serisë B, sepse e njoh mirë këtë klub, edhe nëse nuk është e lehtë të zbresësh në kategori. Këtu ka ekipe të forta dhe është kënaqësi të përballesh me lojtarë të shkëlqyeshëm.

**Çfarë do të bëni sezonin e ardhshëm?**

**Berisha:** Sinqerisht, nuk e di akoma. Ndeshjet e ardhshme do të jenë vendimtare edhe për mua, por nuk kam folur ende për të ardhmen. Kah fundi i muajit tjetër do të di më shumë.

**Në aspektin taktik, preferoni të keni një mbrojtje me tre apo katër para jush?**

**Berisha:** Për mua si portier nuk

ndryshon shumë. Personalisht mendoj se Spal duhet të mësohet të luajë në të dyja mënyrat, sepse trajneri vendos në bazë të dëmtimeve. Gjëja më e dobishme është të jesh në gjendje të prodhosh shfaqje të mira në shtëpi me formacione të ndryshme.

**Ky sezon, për ju përkoji gjithashtu me një shtrim në spital për Covid-19. Çfarë shije ju la kjo përvojë?**

**Berisha:** Ishte shtrimi im i parë në spital dhe gjithmonë do ta kujtoj atë si një moment shumë të vështirë. Kam parë vuajtjet e kaq shumë njerëzve nga afër. Tani jam i lumtur të shoh që situata globale po përmirësohet.

**A keni një ëndërr me Shqipërinë?**

**Berisha:** Ne besojmë në mrekullinë e kualifikimit për Kupën e Botës tjetër sepse kemi një trajner me përvojë si Reja. Ai është i dashuruar me Ferrara dhe Spal, di gjithçka për këtë klub. Më pëlqen të flas shpesh me të.

## Boksierët e Kosovës po përgatiten në Shkodër

PRISHTINË, 29 PRILL - Boksierët e Kosovës (sendorë) nga 26 prilli kanë filluar përgatitjet e përbashkëta me Kombëtaren e Shqipërisë në Shkodër. Këto përgatitje janë të mirëseardhura për boksierët "dardanë" para Kampionatit Ballkanik, i cili do të mbahet nga 5 deri më 10 maj në Zagreb. Në këto përgatitje, selektori Shefki Bogujevci

ka përzgjedhur boksierët: Bashkim Bajoku (52 kg), Shpetim Bajoku (64 kg), Patriot Behrami (69 kg) dhe Besart Pireva (81 kg). Në Kampionatin Ballkanik do të marrë pjesë edhe Donjeta Sadiku (60 kg), e cila pas përgatitjeve në Finlandë me Mira Potken, do t'i vazhdojë përgatitjet në Prishtinë me selektorin Besim Brahimin deri në datën e

nisjes për në Zagreb. Në këtë kampionat drejtësinë do ta ndajë edhe gjyqtari ndërkombëtar Latif Demolli së bashku me katër gjyqtarë: Agim Shala, Agim Tahiraj, Visar Ibrahimimi dhe Marigona Beadini, të propozuar nga Shoqata e Gjyqtarëve që do t'u nënshtrohen provimeve për licencë ndërkombëtare AIBA.



## Muhaxheri: Humbja erdhi si pasojë e gabimeve tona

PRISHTINË, 29 PRILL - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll pësoi humbje nga Mali i Zi (27:22) në ndeshjen kualifikuese për "Euro 2022". Trajneri i Kosovës, Fatmir Muhaxheri, ka thënë se humbja erdhi si pasojë e disa gabimeve

nga hendbollistët "dardanë". "Djemtë dhanë maksimumin dhe u munduan të fitojnë ndeshjen, por patëm disa gabime teknike të cilat na kushtuan. Humbëm disa topa të cilët nuk është dashur t'i

humbim dhe na kushtuan dy kundërsulme ballë për ballë me portierin Simiq. Edhe portieri ynë priti disa gjuajtje dhe tre topat e pritur nga ai, i kapi pivoti i tyre dhe shënoi gola. Nuk mund të them se po të mos i bënim

gabimet nuk do të humbnim, por do të ishim të barabartë. Djemtë u angazhuan, portieri ynë nuk ishte në ditën më të mirë të tij dhe për këtë arsye erdhëm deri këtu", ka thënë Muhaxheri.



## Utah dhe Phoenixi rikthehen te fitoret, humbasin clippersat dhe lakersat

LOS ANGELES, 29 PRILL - Phoenix Suns i shkakton humbjen e dytë radhazi Los Angeles Clippersit pasi arriti ta mposhtë në Arizona me rezultatin 109-101. Chris Pauli fitoi bastin ndaj Paul Georges duke ndihmuar Phoenixin për ta mposhtur ish-skuadrën e tij. 28 pikë, 3 rebounde dhe 10 asistime të Chris Paulit rezultuan vendimtare për Phoenixin që u ndihmua edhe nga loja e mirë e yllit të skuadrës Davon Booker i cili koleksionoi në total 21 pikë, 6 rikuperime poshtë tabelës dhe 3 asistime. Paul George në krahun tjetër ndjeu mungesën e Kawhi Leonardit dhe Serge Ibakasi të dëmtuar dhe i vetëm pavarësisht se koleksionoi 25 pikë, 10 rebounde dhe 4 asistime nuk mundi ta evitonte disfatën e clippersave. Një fitore spektakolare mori Utah Jazzi që la pas ecurinë prej dy humbesh radhazi me një triumf të thellë me rezultatin 154-105 brenda në Golden 1 Center përballë Sacramento Kings. 49 pikë diferencë në një sfidë të dominuar nga fillimi në fund nga Utah që iu fal edhe 24 pikëve të realizuara nga kroati Bojan



Bogdanoviq dhe 23 pikëve të tjera të Jordan Clarksonit. Kur mbeten edhe 10 ndeshje deri në fund të sezonit të rregullt, skuadra nga Salt Lake City kryeson konferencën e Perëndimit, por ndiqet hap pas hapi nga Phoenix Suns. Los Angeles Lakersi pësoi humbjen e 4-të në 5 ndeshjet e fundit pasi u mposht në kryeqytet nga Washington Wizardsi me rezultatin 116-107 dhe tashmë rrezikon edhe vendin e 5-të në Perëndim. Bradley Beal fitoi duelin person-

al me Anthony Davisin duke realizuar një pikë më shumë 27 kundrejt 26 të yllit të Lakersit që vazhdon të ndiejë mungesën e liderit të ekipit LeBron James. Një fitore të ngushtë, por shumë të rëndësishme regjistroi edhe të të përherëshmit Nikola Jokiq, me serbin që spikati me 32 pikë, 7 rebounde dhe 8 asistime.

## Pochettino: Nuk e merituar humbjen

PARIS, 29 PRILL - Trajneri i PSG-së, Mauricio Pochettino, ka thënë se nuk po ka shpjegim për mënyrën se si skuadra e tij pranoi dy gola në ndeshjen ndaj Manchester Cityt (1-2) në kuadër të gjysmëfinale së Ligës së Kampioneve. "Vazhdoj ta mendoj në kokën time dhe ende nuk arrij të gjej një shpjegim. Rezultati final u vendos nga dy gola që jo vetëm ishin të evitueshëm, por është e vështirë që t'i pranoj se si ndodhën. Ishin dy situata që kurrë ndonjëherë mund të jenë të rrezikshme. Prandaj, më kuptoni kur them që nuk e kapërdij dot këtë. Dominuam në pjesën e parë në mënyrë totale, e përsëris, totale... Nuk meritonim ta humbnim, por kur sheh që të të



ndodhin më pas dy episode të çmendura që të bëjnë të humbësh një ndeshje të cilën nuk mendohej se do ta humbnim, kjo më bën shumë nervoz", ka thënë Pochettino. "Sa shanse kemi për përmbysjen? Është një

gjysmëfinale e Ligës së Kampioneve... Dhe, pse jo, shpresojmë që fati në Manchester të na ndihmojë edhe ne ashtu siç bëri me Cityn, ndonëse nuk na mungon asgjë që ta përmbysim", ka deklaruar Pochettino.

## Xavi: Messi nuk është ndjerë i lumtur në Barcelonë

Dy muaj para se të skadojë marrëdhënia kontraktuale midis Leo Messi dhe Barcelonës, tifozët katalanas janë ende në pritje të vendimit që argentinasi do të marrë për të ardhmen e tij. Nëse ka një futbollist që i njeh ndjenjat e Leo

Messit, ai është Xavi Hernandez, me të cilin ndau një dhomë zhveshje për 11 sezone. Trajneri aktual i Al Sadd në Katar ka analizuar situatën e argentinasi në një dokumentar që po përgatitet për numrin "10". "Që Leo nuk është ndjerë i lumtur në atë

që unë e konsideroj klubin e jetës më trishton. Është dashur të bëhet shumë keq situata, në mënyrë që ai të mos ndihet i lumtur. Ne duhet të sigurohemi që Leo të jetë i lumtur, sepse me atë të kënaqur kemi më shumë shanse për të fituar tituj.

Shumë herë më ka dhënë përshtypjen se Leo nuk ka qenë i lumtur në fushë, se ka qenë i trishtuar. Më vjen keq si katalanas që nuk kemi përfituar sa duhet prej tij në vitet e fundit. Historia dhe ne nuk kemi përfituar sa duhet", ka deklaruar Xavi.

### SHKURT

#### KV Drita kualifikohet në finale

Federata e Volejbollit e Kosovës ka bërë me dije se KV Drita ka arritur që ta fitojë ndeshjen përcaktuese gjysmëfinale të "play-off"-it për ta siguruar finalen duke synuar titullin e Kosovës. Gjilanasit në qytetin e tyre u treguan më të mirë sesa ferizajasit, në gjysmëfinalen e tretë, të cilën e fituan 3:2. Në finale, Drita do të ballafaqohet me ekipin më të mirë të sezonit të rregullt, Pejën. Peja më herët në dy ndeshje e kishte siguruar finalen, pasi i fitoi të dyja ballafaqimet me Golden Eagle Therandën. Kampione shpallet skuadra që arrin tri fitore në serinë e finaleve.

#### Marquez: Nuk kam prekur motor me dorë që dhjetë ditë

I rikthyer në pistë dhjetë ditë më parë në garën e zhvilluar në Portimao, pas 9 muajsh pushim, piloti spanjoll Marc Marquez përgatitet për sfidën e radhës në MotoGP. Spanjollit i Hondas do të garojë këtë fundjavë në pistën e Jerez, një pistë e dashur për të. "Gradualisht kemi hyrë në ritmin e garës", ka thënë Marquez. "Gjatë këtyre dhjetë ditëve jam përpjekur të stërvitem sa më shumë, për të rikuperuar 100% fizikisht. Nuk kam prekur motor me dorë që nga gara e Portimao, por dua të qëndroj duarkryq. Po ndjek këshillat e mjekëve, për të qenë gati për sfidën e radhës, ku mund të synoj diçka më shumë", ka thënë Marquez.

#### Guardiola: Duhet të jemi vetvetja në ndeshjen e kthimit

Manchester City e ka fituar ndeshjen kundër PSG-së (1-2), por trajneri Pep Guardiola ka thënë se lojtarët e Cityt duhet të mos dalin nga vetja por ta luajnë lojën e vet në ndeshjen e kthimit. Marquinhos e kaloi PSG-në në epërsi, por City e përmbysi rezultatin me golat De Bruyne dhe Riyad Mahrez. "E gjitha që kërkoj unë është të jemi vetvetja në ndeshjen e kthimit. Ne jemi të mirë kur luajmë në një mënyrë të caktuar dhe prandaj nuk mund të luajmë në mënyrë tjetër. Shpresoj se do t'i gjejmë fjalët e duhura dhe vendimet e duhura për ta bërë këtë", ka deklaruar Guardiola.

#### Chelsea, gati 90 milionë euro për rikthimin e Lukakut

Sulmuesi i Interit, Romelu Lukaku kërkohet që një kohë të gjatë nga Manchester City, kurse tash garës për sulmuesin shtatlartë i ka hyrë edhe Chelsea. "The Sun" raporton se klubi londinez është gati të shpenzojë 90 milion euro për belgun, i cili po shkëlqen në Itali. Chelsea ka dalë jashtë garës për Haaland dhe ka piketuar Lukakun si qendërsulmuesin e ardhshëm. 27-vjeçari cilësohet si lojtari perfekt për skemat e trajnerit Thomas Tuchel. Lukaku shënon rregullisht, por bën edhe një punë të madhe për skuadrën. Tani pritjet përgjigja e klubit italian. "Zikaltrit" nuk kanë ndërmend të heqin dorë nga bomberit, por milionat e ofruar nga Anglia tundojnë. Nëse palët arrijnë marrëveshjen mes tyre, Lukaku do të rikthehej pas plot shtatë viteve te Chelsea.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës shpall:

## KONKURS

### Për zgjedhjen e shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4.8 të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturorë, dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë (KKTK), shpall konkurs për zgjedhjen e shtatë (7) anëtarëve.

#### Përbërja e KKTK-së

KKTK përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët zgjedhën për një mandat tre (3) vjeçar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke respektuar përbërjen etnike në Kosovë.

#### Funksionet e KKTK-së:

- Vlerëson dhe shpall trashëgiminë kulturore në mbrojtje të përhershme;
- Vlerëson të gjitha projektet e trashëgimisë kulturore të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse;
- Identifikon masat e domosdoshme të mbështetjes financiare për trashëgimi kulturore;
- Vlerëson të gjitha asetet më rastin e shpronësimit dhe shitblerjeve.

#### Kandidati/ja për t'u zgjedhur anëtar i KKTK-së duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të jetë shtetas dhe banor i përhershëm i Republikës së Kosovës;
- Të ketë etikë të lartë profesionale;
- Të ketë së paku diplomë universitare katër (4) vjeçare ose Mastër, në fushën e trashëgimisë kulturore, fushës së arteve, arkeologjisë, arkitekturës, historisë, sociologjisë, etnologjisë dhe antropologjisë kulturore;
- Të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Kandidatët që kanë botime, publikime, aktivitete në fushën e trashëgimisë kulturore kanë përparësi;
- Të jetë njohës i legjislacionit në fuqi për trashëgimi kulturore, si dhe konventave ndërkombëtare;
- Të mos jetë i dënuar për vepër penale, të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.

#### Mandati i anëtarëve të Këshillit

- Anëtarët e KKTK-së zgjedhën për mandat tre (3) vjeçar.

#### Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Aplikacionin;
- Autobiografia (Curriculum Vitae);
- Letër motivuese;
- Dy referenca,
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përgatitjen shkollorë dhe profesionale;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është nën hetime ose i dënuar për ndonjë vepër penale.

### PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **14.05.2021, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:  
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

#### Aplikacionet mund të merren në këto vende:

*Forma e shtypur:* në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

*Forma elektronike:* faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonë, konsiderohet i pavlefshëm.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo raspisuje:

## KONKURS

### Za izbor sedam (7) članova Saveta Kosova za kulturno nasleđe

Skupština Republike Kosovo, na osnovu člana 4.8 Zakona br. 02/L-88 o Kulturnom nasleđu i u cilju ispunjavanja zakonskih obaveza za izbor članova Saveta Kosova za kulturno nasleđe (SKKN), raspisuje konkurs za izbor sedam (7) članova.

#### Sastav SKKN

SKKN je u sastavu od sedam (7) članova, koji se biraju sa mandatom od tri (3) godine od strane Skupštine Republike Kosovo, poštujući etnički sastav na Kosovu.

#### Funkcija SKKN:

- Ocenjuje i objavljuje kulturno nasleđe u stalnoj zaštiti;
- Ocenjuje sve projekte kulturnog nasleđa, koje podnose institucije dotičnih oblasti;
- Identifikuje neophodne mere finansijske podrške za kulturno nasleđe;
- Ocenjuje sve asete, prilikom eksproprijacije i kupoprodaje.

#### Kandidat za izbor člana SKKN dužan je da ispuni sledeće uslove:

- Da bude državljanin i stalni stanovnik Republike Kosova;
- Da poseduje visoku profesionalnu etiku;
- Da ima najmanje četiri (4) - godišnju univerzitetsku diplomu ili Master u oblasti kulturnog nasleđa, oblasti umetnosti, arheologije, arhitekture, istorije, sociologije, etnologije i kulturne antropologije;
- Da ima najmanje sedam (7) godina profesionalnog radnog iskustva u oblasti kulturne nasleđa;
- Kandidati koji imaju publikacije i drugi aktivnosti u oblasti kulturnog nasleđa imaju prioritet;
- Da je poznavalac zakonodavstva na snazi o kulturnom nasleđu, kao i međunarodnih konvencija;
- Da nije kažnjavan za krivično delo, kažnjivo više od šest (6) meseci;
- Poznavanje stranih jezika je prednost.

#### Mandat članova Saveta

- Članovi SKKN biraju se sa mandatom od tri (3) godine.

#### Aplikaciji mora da se prilože sledeći prateći dokumenti:

- Aplikacija;
- Autobiografija (Curriculum Vitae);
- Motivaciono pismo;
- Dve reference;
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije pod istragom ili kažnjavan za krivično delo.

### PROCEDURA KONKURISANJA

#### Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 14.05.2021. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:  
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

#### Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

*Štampana forma:* u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u

*Elektronskom obliku:* internet-stranica Skupštine Republike Kosova – [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažnim.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " Qallaku Petroll " Sh.P.K Pejë., në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në Brezhanik, Komuna e Pejës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 21.05.2021 në ora 10:00 në Hapësirat e Objektit të Kompanisë "Qallaku Petroll" rruga: Beteja e Logjës-tranzit. Pejë, do të organizohet debat publik nga Kompania " Qallaku Petroll " Sh.p.k Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në Brezhanik, Komuna e Pejës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:  
<https://us04web.zoom.us/j/79847094647?pwd=Q3B1WUMOWUxDRk1VWVlVUQrbXhmdz09>

Meeting ID: 79847094647  
Passcode: 6EQ32h

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " Qallaku Petroll " Sh.p.k Pejë. për projektin e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në Brezhanik, Komuna e Pejës.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " Magic Ice Joint Company" Sh.A. Lipjan , në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qumshtoren dhe prodhimin e qipsave në Konjuh, komuna e Lipjanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 21.05.2021 në ora 11:00 në hapësirat e administratës të kompanisë Magic Ice Joint Stock Company, Rr. Zona Industriale Magj. Prishtinë – Ferizaj, në Konjuh komuna e Lipjanit.

Do të organizohet debat publik nga Kompania " Magic Ice Joint Stock Company" Sh.A. Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qumshtoren dhe prodhimin e qipsave në Konjuh, Lipjan. Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:  
<https://zoom.us/j/96861018447?pwd=TVpZWVYQkpWQkUyZnJTMUlwcU51UT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " Magic Ice Joint Company" Sh.A. Lipjan për qumshtoren dhe prodhimin e qipsave në Konjuh, Lipjan.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Medzit Mislimi shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Arben Tanaj shpall të pavlefshme dëftesat e Kl I - VIII shfmu " Emin Duraku " Prizren.
- ▶ Eda Vehapi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Emin Duraku " Prizren.
- ▶ Karanfil Elez Kurtaj shpall të pavlefshme dëftesat shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhurë.
- ▶ Arlinda Halimi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shml " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Hasime Shala shpall të pavlefshme dëftesat e shfmu " Kongresi i Manastirit " Studencan.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

